



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:021816
Datë: 02.11.2018
Numri i dokumentit: 00160785

P.nr.2715/17,P nr.2753/17 dhe P nr.2799/17

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
DHE I Detyruar
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROSEVAC

20. 12. 2018



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - Divizioni Penal, me gjyqtarin individual Elmaz Zenuni dhe me zyrtares ligjore Liridona Mehmeti në çështjen penale kundër të akuzuarit: [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, për shkak të tri veprave penale vjedhja e pyllit nga nei 358 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe ate: PP/II.nr.1816-6/17 dt.30.10.2017, PP/II nr.1815-6/17 dt.02.11.2017 dhe PP/II nr.2071-7/2017 dt.09.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Bahri Hyseni, të pandehurit, me datën 02.11.2018, mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, i lindur me dt. [REDACTED] në fshatin [REDACTED] të Ferizajt nga i ati [REDACTED] ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] të Ferizajt, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me nr.personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

- I. Sepse me datën 26.07.2017 rreth orës 19:00 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural-Zyra në Ferizaj në Rajonin e Ekonomisë Pyjore "Nerodime-Jezerc" në vendin e quajtur "Plenijat" me qëllim vjedhje me sharë motorike ka prerë 1(një) trung të llojit ahu me dimensione të gjata, Boniteti III me diametër 35 cm,gjithësejt në kubaturë prej 2.30 metra katëror, i ka bartur me automjetin e tipit Xhip ,vlera e dëmit të shkatuar është 310.50 euro,-
- II. Sepse me datën 26.08.2017 rreth orës 13:00 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural-Zyra në Ferizaj në Rajonin e Ekonomisë Pyjore "Nerodime-Jezerc" në vendin e quajtur "Plenijat" me qëllim vjedhje me sharë motorike ka prerë 1(një) trung të llojit ahu me dimensione të gjata, Boniteti III me diametër 60 cm, gjithësejt në kubaturë prej 3.00 metra katëror, i ka bartur me automjetin e tipit Xhip ,vlera e dëmit të shkatuar është 405.00 euro,-
- III. Sepse me datën 06.09.2017 rreth orës 13:00 në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural-Zyra në Ferizaj në Rajonin e Ekonomisë Pyjore "Nerodime-Jezerc" në vendin e quajtur "Plenijat" me qëllim vjedhje me sharë motorike ka prerë 1(një) trung të llojit ahu me dimensione të gjata,Boniteti III me diametër 35 cm,gjithësejt në kubaturë prej 2.30 metra katëror, i ka bartur me automjetin e tipit Xhip ,vlera e dëmit të shkatuar është 310.50 euro,-
- me të cilën kryen veprën penale vjedhja e pyllit në VAZHDIM nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Në bazë të dispozitës së lartshënuar neni 358 dhe neneve: 4,7,17,21,41,42,43,48,73,74 të KPRK-së, si dhe neni 365 të KPPRK-së.

G J Y K O N

- o TË PANDEHURIN [REDAKTUAR] ME DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 3 /tre/ Muaj, në mbështetje të nenit 48 par. 1 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burg me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet: në

-
- punë në DOBI TË PËRGJITHSHME prej 240 orëve të cilin do ta kryej në afat prej 6 muaj, prej ditës së fillimit të ekzekutimit.
- Konform nenit 48 par. 2 të KPRK-së, Shërbimi Sprovues i Kosovës në Prishtinë, cakton llojin e punës që duhet të kryejnë personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditën, javën që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme shoqërore si dhe mbikëqyrjen e punës në dobi të përgjithshme shoqërore.
- Në mbështetje të nenit 48 par. 4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata do të urdhëroj zbatimin e dënimit të shqiptuar sipas këtij aktgjykimi në përpjesëtim me punën e kryer.
- OBLIGOHET i akuzuari që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rrural-Zyra në Ferizaj të ia kompensoj dëmine shkaktuar për Pikën I, II. dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi në lartësi për 1150.00 (me shkronja: një mijë e njëqind e pesdhjetë euro) në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohen i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ € në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Arsyetime

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzat e veta: PP/II.nr.1816-6/17 dt.30.10.2017,PP/II nr.1815-6/17 dt.02.11.2017 dhe PP/II nr.2071-7/2017 dt.09.11.20127, ka akuzuar [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt, për shkak të tri veprave penale vjedhja e pyllit nga nei 358 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe ate: PP/II.nr.1816-6/17 dt.30.10.2017,PP/II nr.1815-6/17 dt.02.11.2017 dhe PP/II nr.2071-7/2017 dt.09.11.20127.

Gjykata për shkak se ka tri aktakuzat për shkak të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës konform nenit 35 par.1.5 dhe 8 të KPPRK-së, me aktvendimin e vet P.nr.2715/17,P nr.2753/17 dhe P nr.2799/17 të datës 17.10.2018, ka bashkuar tri lëndët penale për të udhëhequr një procedurë të përbashkët.

Gjykata duke vepruar sipas këtyre akuzave caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 02.11.2018, në të cilën shqyrtim mori pjesë prokurori i shtetit Bahri Hyseni i cili mbeti në tërësi pranë aktakuzave dhe kualifikimit juridik të veprave penale,ku ka propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të denohet sipas ligjit.

Konform nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajsisë, i akuzuari e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzave për veprat penale që e ngarkon prokurori i shtetit.

Në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit gjyqtari gjykues konform nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit përkitazi me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, ashtu që prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit të cilët kanë deklaruar se mundë të shkohet me shqiptimin e dënimit,por propozon që të akuzuarit të i shqiptohet denim me punë në dobi të përgjithshme.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni duke paraqitur mendimin e tij rreth pranimit të fajësisë deklarojë se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi një pranim i tillë nga ana e tij është bërë vullnetarisht dhe i njëjti e ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë i cili është në pajtim me nenin 248 të KPRK-së dhe i propozon gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, të njëjtit ti shpallë fajtor dhe tu shqiptojë një sanksion të paraparë me ligj me propozim për punë në Dobi të përgjithshme.

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajsisë,
- Pranimi është bërë vullnetarisht,,
- Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezentuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe ate: deklarata e të pandehurit me të cilën e pranon fajsinë,dëshmitarëve: [REDAKTUAR] dhe Fletëparaqitjet e Rojës së Pyllit me nr.550/2017, 551/2017 dt. 29.08.2017 dhe 637/17,
- akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike, njashtu i akuzuari është udhëzuar nga ana e Gjyqtarit gjykues edhe konform nenit 383 par.2 të KPPRK-së, përkitazi me të drejtën e ankesës vetëm për sanksionin penal, por jo edhe për shkak të gjendjes faktike, si dhe
- Konform nenit 257 të KPPRK-së, aktakuza nuk ka prova të pa pranueshme.

I akuzuari [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar në fjalën e tij në kuptim të mbrojtjes ka deklaruar, pasi e ka pranuar fajësinë lidhur me veprat penale që e ngarkon prokuroria është penduar thellë për atë që e ka kryer, kërkon falje për këto vepra,i premtom gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej asnjë vepër penale dhe i ka propozuar gjykatës që me rastin e matjes së dënimit si rrethana letësuese ti ketë theksësimet e sipër theksuara dhe me pëlqimin e të pandehurit pranon që të punoj në dobi të përgjithshme.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit kanë egzistuar të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale vjedhja e pyllit në vazhdim nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

(Nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit duke mos administruar fare prov, pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor,si dhe pa paraqitur fare fjalë përfundimtare, lidhur me këtë shih Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, sjelljen korrekte gjatë tërë procedurës, si dhe në shqyrtimin fillestar dhe se është i gjendjes së varfër, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rëndues, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata, është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet ne dispozitat e nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata, aplikoi dispozitën ligjore të nenit 81 të KPRK-së dhe të akuzuarit ia shqiptoi një dënim të vetëm për vepër penale në vazhdim. Edhepse, vepra penale përbëhet prej disa veprave gjykata ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore që veprat penale të akuzuarit të i cilësohen si vepra penale në vazhdim, pasi që plotësohen kushtet vijuese:

- *I dëmtuari është i njejt,*
- *Objekti i çështjes është i njejt,*
- *Marrëdhënja e njejt, përkatësisht kontinuitet kohor dhe*
- *Hapsira e njejt e kryerjes së vepërës penale.*

Gjykata të pandehurin [REDAKTUAR] **ME DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej 3 /tre/ Muaj, në mbështetje të nenit 48 par. 1 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burg me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet: në punë në DOBI TË PËRGJITHSHME prej 240 orëve të cilin do ta kryej në afat prej 6 muaj, prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Konform nenit 48 par. 2 të KPRK-së, Shërbimi Sprovues i Kosovës në Prishtinë, cakton llojin e punës që duhet të kryejnë personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditën, javën që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme shoqërore si dhe mbikëqyrjen e punës në dobi të përgjithshme shoqërore.

Në mbështetje të nenit 48 par. 4 të KPRK-së, nëse personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata do të urdhëroj zbatimin e dënimit të shqiptuar sipas këtij aktgjykimi në përpjesëtim me punën e kryer.

Numri i lëndës: 2018:021816
Datë: 02.11.2018
Numri i dokumentit: 00160785

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së OBLIGOHET i akuzuari që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi,Pylltari dhe Zhvillim Rural-Zyra në Ferizaj të ia kompensoj dëmine shkaktuar për Pikën I., II. dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi në lartësi për 1150.00 (me shkronja:njëmijë e njëqind e pesdhjetë euro) në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 453 të KPPRK-së Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzet/ € në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

P.nr.2715/17, P nr.2753/17 dhe P nr.2799/17 me datë 02.11.2018

Zyrtarja ligjore,
Liridona Mehmeti

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve,
pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.
Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj .

